



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:298537

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724018

**2023:298538**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me pjesëmarrjen e praktikantes së kësaj gjykate Altinë Maliqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve G.S. dhe L.Sh. për shkak të veprës penale se secili veç e veç kanë kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1935/2023 të datës 26.12.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Sedat Topalli, të akuzuarve pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 23.05.2024 përpiloi me shkrim këtë:

**AKTGJYKIM**

**Të akuzuarve**

**1. G.S.** nga i ati N. dhe e ëma N. e gjinisë B.. i lindur më datë 27.12.1996 në fshatin R... Komuna Ferizaj, me vendbanim në rrugën "D...", hyrja II, kati i I..., nr.7, në Ferizaj, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer Fakultetin e Gjuhës Angleze, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal:....

**2. L.Sh.** nga i ati I. dhe e ëma K., e gjinisë M..., e lindur më datë .. në Prishtinë, me vendbanim në rrugën "...",nr.66, në Ferizaj, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës me nr. personal:....

## JANË FAJTOR

Me datë 20.08.2023, rreth orës 20:20h, në rrugën “E...” në Ferizaj, njësitë policor reagues në kuadër të planit operativ “Goditja-2023” kanë ndalë veturën e markës “..”, ngjyrë e zezë, me targa 05-..., të cilën ishte duke ngasur i pandehuri G.S., ndërsa pasagjere ishte e pandehura L.Sh. gjatë kontrollit rutinë - trupor të të pandehurve dhe veturës është gjetur një sasi e substancave narkotike e llojit marihuana dhe një pako me “rizlla” (letër për mbështjelljen e substancës narkotike-marihuanës), të cilën e posedonte i pandehuri G.S., kurse tek e pandehura L.Sh. është gjetur një “cigare e mbushur me substancë narkotike e llojit marihuana, si dhe tri fara të bimës “Canabis Sativa”, të cilat substanca të pandehurit i posedonin se cili veç e veç pa autorizim, me ç’ rast të njëjtat i sekuestrohen përkohësisht, ashtu që nga raporti i testit fushor me nr. të rastit R-2023-..., të datës 19.09.2023, nga konstatimi dhe mendimi përfundimtar ka rezultuar se dëshmia D#1 me peshë të përgjithshme 1.475 gram. përmban Kanabis (Marihuanë), të sekuestruar nga i pandehuri G.S., D#2 cigare e mbushur me narkotik të llojit marihuana me peshë neto të përgjithshme: 0.666 gram dhe D#3 tri fara të bimës “Canabis - Sativa” me peshë të përgjithshme 0.051 gram të sekuestruara nga e pandehura L.Sh.,-

**Me të cilën veç e veç kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.**

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 17, 38, 39,43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453 të KPPRK-së, të akuzuarin, e

## IGJYKON

### Të akuzuarit:

**1.G.S.** me dënim me gjobë në shumën prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**2. L.Sh.** me dënim me gjobë në shumën prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim i akuzuara është i obliguar ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, e njëjta konform dispozitave të nenit 46 par.4 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që njëzetë (20) euro gjobë të papaguara do të jenë ekuivalente me një (1) ditë burg.

Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€ në afat prej tridhjetë /30/ ditëve, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohen të akuzuarit secili veç e veç konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 20 Euro /njëzet/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme D#1 me peshë të përgjithshme 1.475 gram, Kanabis (Marihuanë), D#2 cigare e mbushur me narkotik të llojit marihuana me peshë neto të përgjithshme: 0.666 gram si dhe D#3 tri fara të bimës “Canabis - Sativa” me peshë të përgjithshme 0.051 gram. sipas nenit 269 par 3 te KPRK-së si sende që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.

### Arsyetimi

## **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.1935/2023 të datës 26.12.2023, kundër të akuzuarve G.S. dhe L.Sh. për shkak të dyshimit se secili veç e veç kanë kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykata pasi vlersoi se është në kompetencë lëndore dhe territoriale për ta gjykuar këtë çështje penale, si dhe pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore që të mbahet seanca gjyqësore mbajti shqyrtimin gjyqësor fillesar me datë 29.04.2024 në të cilin shqyrtim morën pjesë prokurori i shtetit Sedat Topalli dhe të akuzuarit G.S. dhe L.Sh..

## **Pranimi i fajësisë nga të akuzuarit**

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të akuzuarit në kuptim të nenit 241 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 241 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 241 par. 4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari G.S. me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ka kërkuar falje dhe shton se është duke u munduar të largohet nga përdorimi i këtyre substancave poashtu nuk është përdorues por nganjëherë kur ka presion e përdor. Premton se nuk do të përsëris veprën penale, duke i propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të ulët.

E akuzuara L.Sh. me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë e vetëdijshëm për pasojat që mund

të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ka kërkuar falje dhe shton se nuk është përdoruese e substancave narkotike por e ka provuar nga kurioziteti. Premton se nuk do të përsëris veprën penale, duke i propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të ulët.

### **Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë**

Prokurori i shtetit Sedat Topalli ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin, pasi pranimi fajësisë është në përputhje me nenin 242 të KPPK-së, ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ky pranim mbështetet në provat dhe faktet e çështjes që përmban aktakuza, i propozon gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit të marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozon gjykatës që si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë i paraparë nga neni 70 par.3 pika 3.10 të KPRK-së ndërsa në pajtim me dispozitat e nenit 269 ar.3 i propozon gjykatës që në mënyrë të përhershme të konfiskohet substanca narkotike e llojit mariuanë me peshë 1,475gr.

### **Vlersimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari**

Meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata vlerëson se ky pranim është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja e vetme gjykyuese konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së vlerëson se;

- i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe
- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 1 të KPPRK-së dhe me këtë rast vlerësoi pranimi i fajësisë nga i akuzuari mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit si: Raporti i testit fushor me nr. të rastit R-2023-XI-..., të datës 19.09.2023, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, me numër të rastit R-2023-XI-..., të datës 20.08.2023 Raporti i Oficerit me numër R-2023-XI-..., të datës 20.08.2023 Deklarata e të pandehurit: G.S., e dhënë në polici, e datës 20.08.2023, Deklarata e të pandehurës L.Sh., e dhënë në polici me datë 20.08.2023, Foto-dokumentacioni që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

### **Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit**

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale : Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitiv të këtij aktgjykimi i akuzuari me veprimet e tij në kundërshtim me dispozitat ligjore ka konsumuar elementet e veprës penale të lartcekur.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, faktin se nuk rezulton të kenë pasur më parë ndonjë aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata rrezikshmërin konkrete të veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se të akuzuarit e kanë bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore-juridike dhe konsifkimi**

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2, nenpar.2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05 L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike D#1 me peshë të përgjithshme 1.475 gram, Kanabis (Marihuanë), D#2 cigare e mbushur me narkotik të llojit marihuana me peshë neto të përgjithshme: 0.666 gram si dhe D#3 tri fara të bimës “Canabis - Sativa” me peshë të përgjithshme 0.051 gram. sipas nenit 269 par 3 te KPRK-së si sende që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal

2023:298538 datë 23.05.2024

Procesmbajtësja  
Altinë Maliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Hakile Ilazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate.